



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**

## **Study program**    **Menaxhimi dhe udhëheqja në arsim**

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	N-MLCCML120C
Titulli	Magjistër nga menaxhimi dhe udhëheqja në arsim
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-618/9
Vendimi për fillim me punë	03-1619/17 (10.11.2017)
Data akreditimit	21.03.2017

## **Përshkrimi i programit**

Programi studimor menaxhimi dhe udhëheqja në arsim synon të ofrojë një gamë të moduleve që përbëjnë bazën e informacioneve dhe të dijeve të avancuara mbi rritjen e nivelit akademik të procesit të transformimit të arsimimit në mjedis, por edhe më gjerë në rajon.

## **Karriera**

Kuadër me njohuri të reja në arsim.  
Aftësi që të bëjë hulumtime në sferën e arsimit.  
Të bëjë krijimin e politikave të arsimit dhe të shkollimit.  
Aftësi për menaxhimin rezultativ me institucionet arsimore.

## **Rezultatet e të mësuarit**

### **Njohuritë dhe të kuptuarit**

- Të kuptuarit e ndryshimeve vendore, rajonale dhe globale në arsim.
- Studentët do të jenë liderë në inovacionet arsimore.
- Studentët do të jenë të udhëzuar drejt për reformat në procesin arsimor të Maqedonisë dhe të rajonit, kështu ata do të posedojnë shkathtësi për implementimin e planeve aksionare dhe për programet për reformë.

### **Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit**

- Studentët do të jenë në gjendje t'i këshillojnë politikanët qeveritarë dhe joqeveritarë për arsimin. Përveç kësaj do t'i planifikojnë nevojat vendore dhe rajonale të kuadrit duke i përshtatur ato me ofertat e burimeve ekonomike të vendit, por, gjithashtu edhe duke i theksuar shkathtësitë e udhëheqjes strategjike.
- Studentët do të mund t'i marrin rolet udhëheqëse në institucionet arsimore në Maqedoni e më gjerë.

## Aftësitë për të vlerësuar

- Studentët do të ballafaqohen me riskun dhe me sfidat e ndryshimeve prej sistemit tradicional në atë modern të arsimit.
- Do të jenë gjendje ta bëjnë vlerësimin e programeve, planeve mësimore, të kuadrit dhe të politikave arsimore.

## Aftësitë e komunikimit

- Do të fitojnë shkathtësi të shkëlqyeshme të komunikimit
- Do të fitojnë aftësi për përdorimin e teknologjisë në klasë dhe në administratë, me qëllim të funksionimit të suksesshëm në shoqëri dhe në institucionet e diturisë.

## Aftësitë e të mësuarit

- Do të fitojnë shkathtësi për t'i udhëhequr shkollat në Maqedoni dhe për implementim të hulumtimeve në institucionet arsimore;
- Do të fitojnë shkathtësi për menaxhim me resurset njerëzore, ekonomike dhe teknologjike;
- Do të ushtrohen dhe do të bëhen kompetentë për marrjen e përgjegjësisë lidhur me avancimin e arsimit. Përmes trajnimit në mënyre efikase do të mund të ndikojnë në mjedise multikulturore dhe multigjuhësore.

## Lista e lëndëve

### Semestri 1

- [MCLM1030] [6.0 SETK] **Hyrje në udhëheqjen e arsimit**
- [EMLM2010] [6.0 SETK] **Psikologjia e arsimit**
- [MCML1040] [6.0 SETK] **Planifikimi strategjik**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### Semestri 2

- [MCLM3030] [6.0 SETK] **Menaxhimi i burimeve njerëzore**
- [MCLM1020] [6.0 SETK] **Evaluimi i institucioneve arsimore**
- [MCLM2030] [6.0 SETK] **Arsimi multikulturor**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e lirë**

### Semestri 3

- [MCLM2010] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [MCLM3010] [6.0 SETK] **Mësimi dhe njohja në arsim**
- [MCLM3020] [6.0 SETK] **Cilësia në mësim**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

### Semestri 4

- [MCLM4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

## Description of courses

### Lëndë obligative

- **Hyrje në udhëheqjen e arsimit**  
Lënda ka përmbajtje të pasur stilesh, cilësish dhe mundësish për menaxhimin e shkollës. Temat kryesore janë: - Stilet e të mësuarit; - Cilësia në shkollë; - Ekipet dhe puna e ekipore; - Menaxhimi i ndryshimeve në shkollë; - Teoria e organizatës; - Klima dhe kultura; - Udhëheqja; - Përcaktimi i takimeve shkollore;
- **Psikologjia e arsimit**

Karakteristikat, lënda dhe detyrat e psikologjisë pedagogjike: - zhvillimi historik dhe disiplina; - lënda e disiplinës; - karakteristikat dhe detyrat e disiplinës; - metodat e psikologjisë pedagogjike; - llojet dhe teoritë e të mësuarit; - të mësuarit dhe transferi i të mësuarit; - motivimi dhe vlerësimi i të mësuarit; - aspektet psikike-pedagogjike të të menduarit; aspektet psikologjike të mësimdhënies;

- **Planifikimi strategjik**

- Planifikimi strategjik për zhvillimin e shkollës; - Misioni i shkollës; - Vizioni i shkollës; - Fushat e ndryshimit dhe të prioritetëve; - Qëllimet e shkollës; - Detyrat dhe aktivitetet; - Plani i evaluimit;

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore**

Lënda paraqet një hyrje në elaborimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përfshin disa aspekte: rëndësinë dhe përmbajtjen e burimeve njerëzore; nocionin dhe konceptin e BNJ-së, planifikimin e fuqisë punëtore; rekrutimin, supozimet themelore të seleksionimit cilësor dhe profesional, trajnimin si proces; monitorimin e performancës në punë; motivimin për punë, edukimin dhe zhvillimin në ndërmarrjet bashkëkohore, zhvillimin dhe menaxhimin e karrierës - me theks të veçantë për tema të menaxhimit të burimeve njerëzore, stresin dhe menaxhimin e stresit, Mobbing-un, luhatjen dhe mungesën nga puna.

- **Evaluimi i institucioneve arsimore**

Në këtë lëndë studentët do të udhëhiqen nga teoritë dhe vlerësimet praktike të organizatave përmes një procesi vlerësues të raporteve të ekspertëve mbi institucionet. Do të trajtohen të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të vlerësimit arsimor, rezultatet e vlerësimit, instrumentet dhe qasjet.

- **Arsimi multikulturor**

Qëllimi i lëndës është që t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri sistematike në fushën e arsimit multikulturor, të disiplinës që merret me studimin e sjelljes së individëve në vendin e punës: organizimin në nivel individual, nivel grupor dhe në nivel të organizatës si një tërësi, në aspektin e arsimit multikulturor.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Objektivat kryesore të lëndës janë që studentëve t'u ofrojë instrumente që kanë të bëjnë me përcaktimin e problemit studimor dhe me krijimin e metodave kërkimore të mbledhjes së të dhënave me studim dhe hulumtim në shkencat shoqërore. Seleksionimi i materialeve të mbledhura, analiza dhe interpretimi shkencor i tyre janë një komponent i rëndësishëm i shqyrtimit të relacioneve kauzale. Lënda është fokusuar në problemet e metodave dhe teknikave sasiore dhe cilësore të hulumtimit.

- **Mësimi dhe njohja në arsim**

Në këtë lëndë përpunohen disa koncepte kyçe të përfshira në marrjen e vendimeve në lidhje me formën e kurrikulit, të teorive të kurrikulit dhe aspektet praktike të planifikimit, zbatimit, vlerësimit dhe hulumtimit. Përveç kësaj, shqyrtohen stilet e të mësuarit dhe inteligjencat e shumëfishta, gjithashtu do të mendohet për mënyrën si këto ide mund të ndikojnë në qasjen e mësimin të shkencës në arsim.

- **Cilësia në mësim**

Përmbajtja e kësaj lënde fokusohet në aftësimin e studentëve për t'i udhëhequr shkollat, për krijimin e një klime të punës në klasë për arsim racional, efektiv dhe pragmatik. Në fakt kalimi i arsimimit të tanishëm tradicional nga të mësuarit për diplomë në të mësuarit për shkathtësi dhe kompetenca për prodhimtari materiale.

- **Punimi i magjistraturës**

Qëllimi i modulit është që t'i aftësojë studentët të zhvillojnë shkathtësitë e tyre në fushën e hulumtimit, d.m.th. t'u ndihmojë atyre në përpilimin e tezës së magjistraturës. Moduli është përpiluar që të jetë sa më praktik dhe njëherësh studentëve t'u jepet mundësia të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të debatojnë lidhur me problemet që lidhen me shkrimin e hulumtimeve shkencore përkatësisht me tezën e magjistraturës. Një gjë e tillë do të kontribuojë në përmirësimin e teknikave hulumtuese dhe do të përparojë stilin e të shkruarit. Pra, studentëve u mundëson ta shkruajnë tezën e magjistraturës me vështirësi minimale dhe me efikasitet maksimal. Është planifikuar që të bëjë përmirësimin e teknikave kërkimore të studentëve dhe në stilin e tyre të shkrimit.

## Lëndë zgjedhore

- **Sociologjia e arsimit**

Lënda synon kërkimin dhe përpunimin e kushteve sociale në institucionet arsimore të cilat edukojnë gjenerata të reja. Temat që do të diskutohen janë: literatura shkencore dhe arsimit, shoqëria dhe arsimit, arsimit dhe tejkalimi i barrierave tradicionale, arsimit në shoqëritë digjitale, puna në të ardhmen, profesionet e reja dhe shkollat, përvoja dhe roli i shkollave si institucione shoqërore, probabiliteti i suksesit të gjeneratave të reja, roli ideologjik i edukimit, shkollat e tanishme dhe roli shoqëror i tyre në BE dhe SHBA.

- **Çështjet juridike në arsim**

Qëllimi i lëndës është aplikimi i metodave themelore hulumtuese, qasja kritike dhe krijuese në mbledhjen e materialeve kërkimore nga e drejta - në fushën e arsimit; të kuptohet qëllimi i procesit të hulumtimit dhe qasja në metodat e ndryshme të hulumtimit; të qenit të përgatitur për të dhënë vështrim kritik; organizimi i debateve shkencore në temën e përkatëse, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e koncepteve kryesore, të koncepteve epistemologjike dhe të kërkimeve shoqërore nga e drejta në fushën e arsimit.

- **Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në arsim (TIKA)**

Qëllimi i lëndës është: - T'i paraqesë konceptet dhe teknologjitë më të avancuara në fushën e TIK. - Të tregohet aplikimi i tyre në procesin e mësimdhënies. - T'u mundësohet studentëve që të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të avancuara në kapitujt e IT aplikacioneve. - Zbatimi praktik i këtyre objektivave në procesin mësimor në kuadër të përpilimit të projektit individual nga ana e studentit.

- **Strategjitë e zhvillimit të mendimit në mësim**

Sistemi arsimor është industria e vetme dhe një sistem themelor për zhvillimin e mendimit, ndërsa mendimi prodhon çdo ide që është rreth nesh. Lënda përqendrohet në krijimin e strategjive që zhvillojnë mendim kritik dhe të menduarit krijues të gjeneratave, si një supozim i ndryshimeve cilësore në mjedis.

- **Hulumtimi në shkollë**

Në këtë lëndë studentët do të fitojnë njohuri dhe shkathtësi të avancuara shkencore, teorike dhe praktike, të cilat mund t'i zbatojnë në institucionet arsimore ku ata punojnë dhe jetojnë. Studentët do të inkurajohen të kryejnë punë kërkimore në fushën e shkencave arsimore me theks të veçantë në institucionet dhe në fenomenet arsimore dhe në punën kërkimore shkencore të studimeve të tyre në master.

- **Retorika**

Retorika, përgjatë historisë së vet prej mbi 2500 vjeçare, retorika shfrytëzohet për shënjimimin e shumë gjërave, por sot me retorikë kuptojmë artin e bindjes nëpërmjet të gjuhës. Retorika shënon mënyrën në të cilën një individ ndërlidhet me një ide apo një ide me qëllim ta bindë tjetrin. Retorika karakterizohet me disa tipare kryesore dalluese. E përkufizon qëndrën nga e cila, kjo lëmi, zbulohet. Retorika më së pari l përkufizon situatat e caktuara tipike të të folurit.

- **Multilingualizmi dhe multikulturalizmi**

Qëllimi i kësaj lënde është shqyrtimi i shumëgjuhësisë në shoqëritë multikulturore, si fenomen social. Ky fenomen është masiv në mbarë botën. Gjatë ligjëratave në mënyrë më të thuktë do të shqyrtohen termat: monokulturalizëm, shumëkulturalizëm, multikulturalizëm. Do të sqarohet nocioni nacionalizmi lingvistik, ku do të theksohet se të paktën ka dy forma të këtij nacionalizmi, ku njëra formë përplasit me tjetrën: për udhëheqësit e vendeve më të fuqishme nacionalizmi ka domethënien e zgjerimit, kurse për pakicat ai merr formën e rezistencës dhe të luftës për afirmimin e identitetit, përballë një presionit të tillë. Vend të shquar në program do të ketë edhe multikulturalizmi në arsim. Në shkollë për multikulturalizmin angazhohen për programe mësimore që përfshijnë përmbajtje që u përkasin kulturave të ndryshme.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet e TI për përpilimin e një punimi shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'ua tregojë studentëve elementet teknike, struktura e tekstit dhe dizajni i një punimi shkencor. T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe shkathtësi nga kapitujt e zgjedhur të aplikacioneve TI që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore e profesionale. Zbatimi praktik i këtyre objektivave, gjatë përpunimit të punimit individual shkencor.

- **Kapituj të zgjedhur të avancuar nga aplikacionet për përpunimin statistikor të të dhënave**

Qëllimi i kësaj lënde është: T'u tregohen studentëve elementet teknike nga lëmi i statistikës: organizimi, përpunimi, krahasimi përmes analizave dhe publikimi i të dhënave. T'u mundësojë studentëve të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi më të përparuara nga kapitujt e zgjedhur të avancuar të aplikacioneve për përpunimin statistikor të të dhënave. Zbatimi praktik i këtyre objektivave në përpunimin statistikor të të dhënave të marra nga pyetësorët, kontributet, studimet shkencore dhe dokumentet tjera.

- **Komunikimi profesional**

Lënda fokusohet në zhvillimin e atyre shkathtësive të komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale. Studentët do ta mësojnë procesin e analizimit të një shumëllojshmërie situatash të komunikimit dhe t'u japin përgjigje adekuate po atyre. Ndër temat që do të përfshihen janë: komunikimi në organizata, komunikimi ndërpersonal dhe grupor, prezantimet gojore, intervistat për punësim, letrat profesionale të biznesit, si dhe shkathtësitë ndërpersonale, duke përfshirë dinamikën e grupit dhe punën ekipore.

- **Tregu i punës**

Qëllimi kryesor i lëndës "Tregu i punës" është t'i pajisë studentët e studimeve të ciklit të dytë me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë të tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda "Tregu i punës" ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale të cilat mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj studenti, për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksion dhe seminar duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme që lidhen me tregun e punës.

- **Metodologjia e mësimdhënies**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me qasjet themelore dhe metodat e mësimdhënies. Pritet që studentët të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për përdorim të mjeteve për mësimdhënie aktive. Gjithashtu, lënda ofron qasje ndaj zhvillimit, mësimdhënies dhe të nxëniet si koncepte, si dhe ndaj normave themelore të cilat mësimdhënësve do t'u mundësojnë të ligjërojnë mbi zhvillimin e mendimit. Përmes kësaj lënde, studentët do të përfitojnë bazë teorike dhe strategji, me çka do të mund ta zhvillojnë të menduarit e tyre kritik, si dhe të menduarit kritik të studentëve.

- **Filozofia e shkencave shoqërore**

Kjo lëndë përfshin pajisjen e studentëve me informata që do t'u mundësojnë atyre përfitimin e diturive, shkathtësive dhe kompetencave në shkencat shoqërore, përfshirë metodologjinë e punës (sqarim, teoretizim, testim), aplikim të filozofisë (në veçanti individualizmi kundrejt kolektivizmit), natyra e racionalitetit, si dhe historia e teorisë dhe koncepteve. Ky modul ofron studim të avancuar të debateve aktuale lidhur me ontologjinë, metodologjinë dhe synimet e shkencave shoqërore. Lënda do të përqendrohet në çështjet qendrore të shkencave shoqërore: etno-metodologjia, evolucioni, fenomenologjia, racionaliteti, relativizmi, metodat shkencore, interpretime tekstuale. Rezultat e të mësuarit: Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Ta kuptojnë qëllimin e shkencave shoqërore si dhe dallimin në mes të të sqaruarit dhe të kuptuarit të sjelljes njerëzore. T'i sqarojnë qasjet e ndryshme në shpjegimin e shkencave shoqërore në krahasim me shkencat shoqërore, specifikat e të qenit qenie njerëzore dhe fenomenet sociale. T'i kuptojnë strukturat sociale, praktikat, normat institucionet etj. si dhe relacionet në mes individëve dhe strukturave më të gjera shoqërore. Ta sqarojnë mbështetjen jo vetëm në fakte për individët dhe gjendjet e tyre mentale, por gjithashtu edhe rastet në të cilat fenomenet shoqërore nuk mundet të sqarohen përmes sjelljeve individuale.

- **Menaxhimi i projekteve**

Me përfundimin e suksesshëm të lëndës, studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e projektit, të identifikojnë ndërvarësitë e tyre, kohëzgjatjen si dhe kostot e tyre; Të përgatisin raportet e nevojshme dhe të kryejnë të gjitha komunikimet e nevojshme ndërmjet projektit dhe klientit, si dhe në mes të anëtarëve të ekipit dhe të aktorëve të tjerë; Të strukturujnë projektin dhe aktivitetet e tij përbërëse; Të përgatisin një Gantt-tabelë dhe një plan të rrjetit për projektin dhe të identifikojnë kohën më të shkurtër të nevojshme për të përfunduar projektin; Të përdorin MS Project si një mjet në procesin e planifikimit, zbatimit dhe rishikimit të projektit; Të përcaktojnë projektin, të identifikojnë lëminë dhe objektivat e tij, si dhe të zhvillojnë specifikat e projektit;

- **Metodat e optimizimit**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i prezantojë teknikat e modelimit dhe të optimizimit me qëllim të aftësisimit të studentëve

në zhvillimin e modeleve të cilat shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve reale në lëmin e shkencave kompjuterike. Në mes tjerash kjo lëndë ka për qëllim ta analizojë rëndësinë e faktorizimit matricor si një mjet shumë i rëndësishëm që ofron modalitete për optimizimin e zgjidhjes së algoritmeve të ndryshme numerike me interes bazik për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga sfera e shkencave kompjuterike. Nëpërmjet kësaj lënde studentët do të kenë mundësi t'i mësojnë teorinë bazike të optimizimit edhe metodat për caktimin e optimumit. Do të analizohen metodat e ndryshme të optimizimit sikurse që është simpleks metoda, problemi i dualitetit si dhe sensitiviteti i problemeve të programimit linear. Qëllimi, po ashtu, është analiza e zbatimit kompjuterik të secilit problem të analizuar duke ofruar edhe modelin përkatës për optimizim.

- **Çështjet etike dhe e drejta në teknologjitë e informacionit (TI)**

Qëllimet e lëndës: Të zhvillon kuptueshmërinë për gjendjen reale në relacionet mes kompjuterëve, ndryshimeve të teknologjisë, shoqërisë dhe ligjit; Të vejë në pah rolin e fuqishëm që kompjuterët dhe profesionistët e kompjuterëve kanë në shoqërinë e teknologjisë; Të ofron të kuptuarit e çështjeve legale që janë relevante për lëminë e kompjuterizimit; Të ofron të kuptuarit e koncepteve etike që janë me rëndësi për shfrytëzuesit e kompjuterëve dhe profesionistët; Të kontribuon në arritjen e eksperiencës së nevojshme në shqyrtimin e çështjeve etike dhe zgjidhjen e dilemave etike.

- **Mbrojta e të drejtave të njeriut**

Qëllimi i kësaj lënde është: të njoftohen studentët me konceptin e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, zbatimin e këtyre të drejtave në praktikë, ndikimin e tyre në krijimin e politikave nacionale, të nxiten studentët të mendojnë në mënyrë kritike për raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe asaj nacionale, të vetëdijësohen për ngjarjet aktuale ndërkombëtare, si ndikojnë ato në jetën e përditshme të njerëzve në botë, ti nxisë studentët ta japin kontributin e tyre në sferën e përgatitjes së ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me shpresë se ata që sjellin vendime do i marrin parasysh në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave shtetërore.